



Kërkesë për zbatimin e detyrimeve për Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinor në Kornizën Afatmesme të Buxhetit dhe Buxhetin Vjetor 2027

[Ligji i Kosovës nr. 05/L-020 për barazinë gjinore](#) kërkon integrimin e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGj) në çdo fazë të planifikimit, miratimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të legjislacionit, politikave, programeve dhe buxheteve në të gjithë sektorët. Moszbatimi i BPGj-së, siç përcaktohet me këtë ligj, përbën shkelje ligjore që mund të rezultojë në sanksione të vendosura nga gjykatat kompetente. Mbi të gjitha, zbatimi i BPGj-së mund të kontribuojë në rezultate më efektive, efikase, me ndikim dhe gjithëpërfshirëse edhe në kushtet e kufizimeve buxhetore. Ne i kuptojmë kufizimet buxhetore me të cilat përballen komunat dhe dëshirojmë të theksojmë se BPGj-ja nuk kërkon domosdoshmërisht ndarje të buxhetit **shtesë**, por më tepër një shpërndarje më të mirë të burimeve **ekzistuese**.

Për të siguruar zbatimin e BPGj-së dhe për të rritur transparencën dhe llogaridhënien në financat publike, përmes [Qarkores Buxhetore](#), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka kërkuar dorëzimin e Aneksit për BPGj së bashku me kërkesat për ndarje buxhetore për vitin 2027 dhe dokumentet e planifikimit të Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB).

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), një rrjet prej 103 organizatash të ndryshme për të drejtat e grave, i bën thirrje **çdo komune që ta dorëzojë këtë Aneks të BPGj-së së bashku me kërkesën e saj për buxhetin vjetor dhe KAB**, si dhe t'i publikojë këto dokumente në faqen zyrtare të komunës, në përputhje me udhëzuesin e Kombeve të Bashkuara për [Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 5, treguesin 5.c.1](#), me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies. Në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me praktikën më të mira për BPGj të përshkruara në kurrikulën¹ e Institutit të Kosovës për Administratë Publike, Aneksi i BPGj-së duhet të përfshijë:

- Një **analizë gjinore** të nevojave specifike të grave dhe burrave të ndryshëm në komunë për secilën drejtori/sector (p.sh., puna dhe punësimi, shërbimet sociale, sporti, arsimiti, bujqësia, kultura, etj.).
- Një **analizë të ndikimit** të mënyrës se si gratë dhe burrat e ndryshëm kanë përfituar nga shpenzimet dhe shërbimet komunale të mëparshme, duke identifikuar çdo pabarazi ose nevojë të paplotësuar sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë, si përkatësia etnike dhe aftësia e kufizuar.
- **Objektiva për secilin sektor** për avancimin e barazisë gjinore përmes shpenzimeve të Buxhetit Vjetor 2027, duke u fokusuar në adresimin e pabarazive të identifikuar përmes analizës gjinore.
- Buxhetin për aktivitetet që synojnë arritjen e këtyre objektivave, siç përfshihen në Buxhetin Vjetor 2027.

Për më tepër, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare për BPGj, ne rekomandojmë fuqimisht që aktivitetet dhe buxhetet e planifikuara të lidhen qartë me programet ekzistuese komunale, objektivat, rezultatet e pritshme, aktivitetet dhe buxhetet përkatëse. Në mungesë të buxhetimit programor, kjo mund t'u bëjë të qartë tatimpaguesve se si buxheti vjetor do të kontribuojë në përmbushjen e angazhimeve të programeve komunale për avancimin e barazisë gjinore në sektorë të ndryshëm.

Korniza Afatmesme e Buxhetit

Komunat duhet ta integrojnë BPGj në KAB. KAB duhet të shërbejë si instrument strategjik i planifikimit që lidh prioritetet e identifikuar për barazinë gjinore me alokimet buxhetore afatmesme dhe rezultatet e pritshme. KAB duhet të përfshijë:

- **Analizën gjinore:** Një analizë e nevojave specifike të grave dhe burrave të ndryshëm në komunë për secilën drejtori/sector (p.sh., punësimi, shërbimet sociale, sporti, arsimiti, bujqësia, kultura, etj.). Gjithashtu, një **analizë e ndikimit** të mënyrës se si gratë dhe burrat e ndryshëm kanë përfituar nga shpenzimet dhe shërbimet komunale të mëparshme, duke identifikuar çdo pabarazi ose nevojë të paplotësuar sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë, si përkatësia etnike dhe aftësia e kufizuar.

¹ Për një përmbledhje, ju lutem referojuni [udhërrëfyesit](#) që është pjesë e kurrikulës.

- **Objektivat:** Objektiva të qarta për avancimin e barazisë gjinore, të bazuara në analizën e nevojave të grave, burrave, vajzave dhe djemve në secilin sektor. Objektivat duhet të përshkruajnë ndryshimin që komuna synon të arrijë në periudhën afatmesme.
- **Treguesit:** Tregues specifikë dhe të matshëm që mundësojnë monitorimin e progresit drejt arritjes së secilit objektiv. Treguesit duhet të jenë të ndarë sipas gjinisë, sa herë që është e mundur, dhe të jenë në përputhje me objektivat e politikave komunale dhe kombëtare.
- **Vlerat bazë:** Vlera bazë të ndara sipas gjinisë për secilin tregues, që paraqesin gjendjen aktuale përpara zbatimit të ndërhyrjeve të planifikuara. Vlerat bazë shërbejnë si pikë referimi për matjen e progresit drejt arritjes së objektivave.
- **Targeti:** Targete realiste vjetore dhe afatmesme që tregojnë nivelin e pritshëm të përmirësimit gjatë periudhës së Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB).
- **Alokimet buxhetore:** Burime të dedikuara financiare të lidhura me secilin objektiv dhe rezultat të pritshëm, duke treguar se si shpenzimet e planifikuara do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve për barazinë gjinore

Për shembull, nëse një komunë identifikon pjesëmarrjen e ulët të vajzave në sport si sfidë, KAB mund të përfshijë një objektiv për rritjen e pjesëmarrjes së vajzave në programet sportive komunale; një vlerë bazë që tregon nivelin aktual të pjesëmarrjes; synime vjetore për përmirësim; tregues për matjen e pjesëmarrjes; si dhe alokime buxhetore për objektet sportive, pajisjet, trajnimet dhe aktivitetet promovuese. Kjo nuk kërkon domosdoshmërisht rritje të shpenzimeve buxhetore, por mund të nënkuptojë rishpërndarjen e një pjese të shpenzimeve që më parë kanë prirë të përfitojnë më shumë djemtë, si një masë afirmative e paraparë me Ligjin për Barazi Gjinore.

Integrimi i objektivave, treguesve, vlerave bazë, targeteve dhe alokimeve buxhetore në KAB do të forcojë llogaridhënien, do të lehtësojë monitorimin e rezultateve dhe do të sigurojë përputhshmëri me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore dhe detyrimet për zbatimin e BPGj.

Alokimet kryesore për barazinë gjinore

Për të mbështetur alokime më të përgjegjshme gjinore në KAB dhe në Buxhetin Vjetor, në përputhje me detyrimet ligjore dhe bazuar në hulumtimin tonë, RrGK rekomandon që të gjitha komunat të planifikojnë buxhet për këto në vijim:

- **Drejtoria e Mirëqenies Sociale:** Të krijohet një linjë buxhetore specifike për dhunën me bazë gjinore, për të mbështetur gratë dhe fëmijët që përjetojnë dhunë dhe kanë nevojë për shërbime emergjente (p.sh., veshje, pajisje mjekësore, produkte higjienike). Të rritet buxheti për Qendrën për Punë Sociale (QPS) në kategorinë “Paga dhe shtesa” me rreth 12,000€ për të mundësuar punësimin e së paku dy punonjësve socialë në përputhje me kërkesat e Protokollit të ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale. Këta punonjës social duhet të specializohen në menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Të ndahet buxheti për instalimin e detektorëve metalikë në hyrje të QPS-ve për të garantuar sigurinë e punëtorëve dhe përfituesve. Mjetet për këto shpenzime të rëndësishme mund të rialokohen nga kategori të tjera buxhetore.
- **Drejtoria e Arsimit:** Sipas nevojës, të ndahet buxhet për rritjen e numrit të qendrave për kujdesin ndaj fëmijëve dhe edukimin e hershëm, në përputhje me [Objektivat e Barcelonës të BE-së](#) dhe zotimet e [Strategjisë Kombëtare për Zhvillim](#), me qëllim të reduktimit të punës së papaguar të kujdesit që kryhet nga gratë dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Të ndahet buxhet për rritjen e numrit të psikologëve në shkolla për trajtimin e dhunës me bazë gjinore, ngacmimit seksual, bullizmit dhe dhunës kibernetike me bazë gjinore që prek fëmijët dhe të rinjtë, në përputhje me [Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave](#). Të rritet numri i asistentëve personalë në shkolla, në mënyrë që të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për një asistent ta kenë atë, në përputhje me [Strategjinë e Arsimit 2022–2026](#). Të përfshihen pecetat higjienike në shkolla për vajzat si pjesë e ndarjes buxhetore për produktet e higjienës. Të sigurohet që [pecetat higjienike](#) të përfshihen si produkte thelbësore në furnizimet higjienike të shkollave. Duke ndjekur shembullin e [Komunës së Obiliqit](#), e cila është zotuar të ofrojë peceta higjienike falas për nxënësit, mësuesit dhe gratë në administratë dhe në sektorin e shëndetësisë, komunat e tjera duhet të sigurohen që pecetat higjienike të njihen si

furnizime thelbësore higjienike në shkolla. Kjo masë e thjeshtë, por me ndikim, promovon barazinë gjinore, mbështet arsimimin e vajzave duke zvogëluar mungesat në shkollë dhe afirmon të drejtën e çdo nxënësi dhe nxënëseje për dinjitet dhe shëndet.

- **Drejtoria e Shëndetësisë:** të ndahet buxheti për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët në bazë të [listës esenciale të furnizimeve mjekësore](#). Të sigurohen fonde adekuate për [shërbimet e shëndetit riprodhues](#), duke përfshirë financimin për mamitë që të shërbejnë gratë në zonat rurale. Të sigurohet [staf i mjaftueshëm për shërbimet shëndetësore në shtëpi](#), duke garantuar që këto shërbime të jenë të disponueshme edhe gjatë fundjavave. Të krijohen [shërbime këshillimore për gratë në menopauzë](#) si pjesë e Qendrave të Mjekësisë Familjare, duke rritur linjën buxhetore për kujdesin parësor shëndetësor.
- **Drejtoria e Bujqësisë:** Për mikrograntet, në përputhje me mbështetjen nga [Ligji për Barazinë Gjinore](#) për përdorimin e masave afirmative në dhënien e subvencioneve, duhet të eliminohen kriteret minimale për pronësinë dhe bashkë-pagimin, [të ofrojë mundësi më të mira për gratë e cenueshme dhe ato nga zonat rurale që nuk i përmbushin këto kërkesa por kanë potencial për zhvillimin e bizneseve të vogla](#).
- **Drejtoria e Shërbimeve Publike:** Të ndahen burime të mjaftueshme për sigurimin e [transportit të rregullt](#) drejt fshatrave të largëta, për të mundësuar që gratë dhe vajzat të kenë qasje në arsim, punësim dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse.
- **Drejtoria e Urbanizimit:** Të ndahet buxheti për ndërtimin e pjerrinave, rrugëve dhe trotuareve për të akomoduar personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit me fëmijë që përdorin karroca, si pjesë e të gjitha investimeve të **planifikuara në infrastrukturë**. Buxheti duhet të përfshijë gjithashtu dispozita për instalimin e ndriçimit shtesë për të rritur sigurinë si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane; krijimin e pllakave taktile për personat e verbër dhe individët me shikim të dobët; zhvillimin e korsive të sigurta për biçikleta si në mjediset urbane ashtu edhe në ato rurale; dhe instalimin e rafteve të biçikletave në vendet kyçe për të siguruar parkim të sigurt. Për më tepër, duhet të ndahen fonde për të renovuar, aty ku është e nevojshme, dhe për të siguruar hapësira falas komunale për organizatat e vogla të shoqërisë civile për të kryer aktivitete gjithëpërfshirëse për burrat, gratë, djemtë dhe vajzat, veçanërisht në zonat ku hapësira të tilla aktualisht nuk ekzistojnë.
- **Drejtoria e Sportit:** Të sigurohen ndarje të barabarta të buxhetit për vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat për t'u angazhuar në sporte të ndryshme në nivel komunal, duke zbatuar masa afirmative për të promovuar barazinë gjinore në sport sipas Ligjit për Barazi Gjinore.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve mund të kontribuojë në adresimin e pabarazive gjinore dhe në avancimin e mirëqenies së të gjithë qytetarëve. Ai mund të ndihmojë duke përfshirë perspektiva të ndryshme dhe duke iu përgjigjur në mënyrë më efektive nevojave të grave dhe burrave të ndryshëm, duke çuar në përmirësimin e qeverisjes, ofrimit të shërbimeve, kohezionit social dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Komuna do të shohë përmirësime në fusha të ndryshme, si transparencja, qasja në informacion dhe integriteti; mirëqenia sociale; bujqësia; shëndetësia; planifikimi hapësinor, transporti publik dhe çështjet mjedisore; si dhe arsimit parauniversitar, ndër të tjera. Ne mirëpresim një takim për të diskutuar këto rekomandime dhe për të ofruar, sipas nevojës, prova të mëtejshme në mbështetje të tyre, bazuar në hulumtimin tonë. Po ashtu, mbetemi në dispozicion për të shqyrtuar draftet e KAB dhe Aneksit të BPGJ-së, për të mbështetur zhvillimin e tyre nëse dëshironi të shfrytëzoni ekspertizën tonë. Gjithashtu, do ta vlerësonim përgjigjen tuaj lidhur me rekomandimet e mësipërme që planifikoni t'i zbatoni.

Me respekt,

Igballe Rogova
Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK)